



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

*Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Kodin Zgjedhor*

Dokument parlamentar

**R A P O R T**

**PËR SHOYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS NR. 5960, DATË 2.12.2008 “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 10019, DATË 18.11.2008 “KODIT ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË””**

**I. Të përgjithshme**

Komisioni Parlamentar i Reformës Zgjedhore, u rithirr në mbledhjen e datës 16.12.2008 në zbatim të Vendimit nr. 226, datë 15.12.2008 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe mori në shqyrtim Dekretin e Presidentit të Republikës, nr. 5960, datë 02.12.2008 “Për kthimin e ligjit nr.10 019, datë 18.11.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Komisioni i kërkoi Grupit të Ekspertëve të shqyrtojë dekretin në fjalë, si dhe të propozojë zgjidhjet juridike të mundshme.

Gjithashtu, Grupit të Ekspertëve iu ngarkua edhe detyra për shqyrtimin e disa propozimeve të paraqitura nga partitë LSI dhe PDK dhe, nëse këto propozime ishin brenda objektit të punës së këtij Komisioni.

Grupi i Ekspertëve, dorëzoi relacionin me propozimin përkatës më datë 2.12.2008, i cili u shqyrtua dhe u miratua nga Komisioni brenda të njëjtës datë.

Mbi këtë bazë, Komisioni i Reformës Zgjedhore i paraqet për miratim Kuvendit relacionin me amendamentin, si më poshtë:

**II. Propozimi**

Pas hulumtimit juridik dhe diskutimeve në grup, Grupi i Ekspertëve e gjeti me vend të propozojë një zgjidhje juridike të pranueshme, e cila shmang keqintepretimin juridik që Presidenti i ka bërë afatit për nxjerrjen e dekretit për mbajtjen e zgjedhjeve në lidhje me afatet e tjera në Kod dhe Kushtetutë, si dhe siguron integritet të tekstit të Kodit, duke shmangur ndërhyrjet e panevojshme në këtë tekst.

Më konkretisht, zgjidhja e propozuar është një **dispozitë tranzitore** që e mundeson Presidentin të nxjerrë dekretin brenda një afati të caktuar kohor, vetëm për zgjedhjet e vitit 2009. Dispozita është hartuar si më poshtë:

**Neni 185**

*“Dekretimi i datës së zgjedhjeve të radhës.*

*Presidenti i Republikës nxjerr dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve të radhës për Kuvend të vitit 2009, jo më vonë se 7 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, në përputhje me pikën 1 të nenit 9 të këtij Kodi.”*

Nenet e tjera pas nenit 185 do të rinumërtohen në vijim.

### III. Analiza ligjore

Presidenti i Republikës me dekretin e datës 2 Dhjetor 2009 e ktheu ligjin për rishqyrtim me arsyetimin se ka mospërputhje neneshe që lidhen me periudhën zgjedhore (neni 8) dhe afatin e dekretimit të zgjedhjeve (neni 9) dhe, si rrjedhim, ishte në pamundësi kushtetuese për dekretim të zgjedhjeve. Në letër thuhet:

*“Arsyeja, për të cilën nuk e dekretova këtë ligj, lidhet me dispozitën e nenit 9, pika 2 e tij. Kështu, neni 9, pika 2 i ligjit ka këtë formulim: “Presidenti i Republikës nxjerr dekretin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin jo më vonë se 9 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit”. Ky rregullim bie ndesh me nenin 8 të ligjit të ardhur për shpallje. “Neni 8 ka parashikuar se zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin apo për njësitë e qeverisjes vendore, zhvillohen njëherësh në të gjithë territorin e vendit brenda periudhës që shtrihet nga 15 Marsi deri më 30 Qershor ose nga 15 Shtatori deri më 30 Nëntor”. Duke qenë që neni 65, pika 2 e Kushtetutës përcakton se “zgjedhjet për Kuvendin e ri zhvillohen në periudhën zgjedhore më të afërt që i paraprin datës së përfundimit të mandatit të Kuvendit”, atëherë periudha zgjedhore brenda së cilës duhen zhvilluar zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme për Kuvendin, është periudha 15 Mars deri më 30 Qershor”;*

Por, aty ku Presidenti shpreh rezervat e tij, është pikërisht Neni 9, pika 2 e ligjit të ardhur për shpallje, që ka përcaktuar detyrimin e Presidentit të Republikës për nxjerrjen e dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin jo më vonë se 9 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit. Në letër Presidenti shprehet:

*“Pra, një afat i cili nuk mund të respektohet për periudhën zgjedhore 15 Mars – 30 Qershor.*

Shkaku dhe arsyetimi ligjor që i ka bërë Presidenti i Republikës kthimit të ligjit mendojmë se është i gabuar.

Po të lexohet me kujdes letra sqaruese e Presidentit për Kuvendin, në thelb pretendohet se ka përplasje mes neneve 8 dhe 9 të Kodit, dhe, si rrjedhim, mund të prekej afati kushtetues për zgjedhjet.

Për të qenë të saktë, neni 8 i KZ flet për periudhën e zgjedhjeve në vend pra 15 Mars -30 Qershor dhe 15 Shtator – 30 Nëntor, ndërsa neni 9 rregullon nxjerrjen e dekretit të Presidentit dhe ditët e mundshme për mbajtjen e zgjedhjeve brenda periudhave zgjedhore që përcakton Kodi. Pra, nuk ekziston asnjë përplasje ndërmjet këtyre neneve. Në çdo rast, data e zgjedhjeve caktohet në periudhën zgjedhore më të afërt që i paraprin fundit të mandatit të Kuvendit aktual, i cili është në fillim të Shtatorit 2009.

Nga përmbajtja e letres, rezulton se Presidenti e ka keqkuptuar afatin 9 mujor që i referohet fundit të mandatit të Kuvendit, dhe jo ditës së mundshme të mbajtjes së zgjedhjeve sipas këtij Kodi, siç arsyetohet në motivimin e dekretit.

Në thelb nuk ka asnjë shkelje të ndonjë afati kushtetues për mbajtjen e zgjedhjeve. E gjejmë të pavend dhe të pabazuar si në aspektin Kushtetues, edhe në atë ligjor, referencën që Presidenti bën në Kushtetutë në letrën e tij. Kushtetuta, pas ndryshimeve të 21 Prillit të këtij viti, përcakton se:

1. zgjedhjet zhvillohen çdo katër vjet, duke afirmuar parimin themelor të “periodicitetit të zgjedhjeve” demokratike;
2. mandati i Kuvendit fillon me mbledhjen e tij të parë;
3. mandati i Kuvendit mbaron në të njëjtën ditë të të njëjtit muaj, të vitit të katërt nga data e mbledhjes së parë të Kuvendit;
4. zgjedhjet zhvillohen në periudhën zgjedhore **më të afërt që i paraprin** fundit të mandatit;
5. periudhat zgjedhore dhe rregullat për thirrjen e zgjedhjeve përcaktohen në ligjin zgjedhor;
6. Presidenti i Republikës dekreton datën e zgjedhjeve.

Sa më sipër, Kushtetuta, në dallim nga dispozitat e shfuqizuara të saj, nuk vendos as afate dhe as rregulla strikte, duke ia ka deleguar Kodit Zgjedhor përcaktimin dhe detajimin e tyre.

E vetmja dispozitë ligjore që i jep rol Presidentit në lidhje me zgjedhjet është neni 92 i Kushtetutës, ku përcaktohet se ai cakton datën e zgjedhjeve. Si rrjedhim, projekt Kodi Zgjedhor parashikoi një afat optimal për nxjerrjen e dekretit prej 9 muajsh nga fundi i mandatit të Kuvendit, e thënë ndryshe, 7 muaj nga data e zgjedhjeve. Ky afat i gjatë u vendos i tillë që të dihej kohë më parë data e zgjedhjeve, pasi shumë aspekte procedurale të Kodit janë të lidhura me datën e zgjedhjeve, duke adresuar kështu një sërë problemesh të hasura më parë në lidhje me qartësinë dhe uniformitetin e afateve dhe përgatitjen e zgjedhjeve.

Pas dërgimit të ligjit për dekretim tek Presidenti i vetmi afat që potencialisht mund të tejkalohet ishte afati 9 mujor nga fundi i mandatit të Kuvendit për caktimin e datës së zgjedhjeve, që, në çdo rast, nuk do të tejkalohet më shumë se disa ditë. Pikërisht tejkalimi i këtij afati, pra, ditës së hyrjes në fuqi të ligjit dhe afatit 9 mujor ishte në themel të pretendimit për pamundësi juridike për dekretimin e ligjit.

Edhe ky argument nuk është i bazuar, pasi afati 9 mujor, i vendosur në Kod, nuk është afat prekluziv dhe nuk sjell asnjë pasojë juridike mbi dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve, nëse kalon afati me disa ditë. Mbi të gjitha, vetë ligji nuk synon dhe nuk mundet të çojë në dekadencë të kompetencës kushtetuese të Presidentit për nxjerrjen e dekretit, por orienton një afat të arsyeshëm për dekretim të datës së zgjedhjeve me qëllim sigurimin e uniformitetit dhe qartësisë së afateve dhe stabilitetit të procesit përgatitor, pa çenuar këtë prerogativë kushtetuese.

Një qëndrim të tillë e ka përforcuar edhe doktrina kushtetuese në fuqi dhe, më konkretisht, Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 6 datë 18.01.2002 shprehet se:

*“Duke qenë kështu, në rastet kur afatet që janë parashikuar nga Kushtetuta për t’u përmbushur janë të lidhura ngushtë me pasojat juridike që passjellin, këto të fundit nuk mund të përmbushen pas kalimit të tyre. E kundërta ngjet me afatet e tjera, për të cilat Kushtetuta nuk ka parashikuar në mënyrë të shprehur pasojat juridike që mund të lindin nga kalimi i tyre. Në raste të tilla, detyrime kushtetuese, nëse nuk janë përmbushur brenda afateve, duhet të përmbushen më vonë”*

E thënë më thjeshtë, asnjë afat që nuk është parashikuar në Kushtetutë, nuk mund ta pengojë Presidentin e Republikës të nxjerrë dekretin për datën e zgjedhjeve, pasi dekreti është një prerogativë dhe detyrim kushtetues pa ndonjë afat të prerë. Mosnxjerrja e dekretit në afatet që parashikonte Kodi Zgjedhor nuk sillte asnjë pasojë juridike mbi dekretin. Mbi të gjitha, nuk mund të kishim as shkelje të vetë afatit ligjor, pasi ligji nuk kishte hyrë në fuqi. Do të ishim para një shkeljeje, nëse ligji do të ishte në fuqi para afatit kalendarik 9-mujor dhe Presidenti nuk do të dekretonte datën e zgjedhjeve. Në rastin konkret, dekretimi i ligjit do të sillte si pasojë hyrjen e tij në fuqi vetëm disa ditë përtej afatit joprekluziv 9-mujor, duke bërë që Presidenti të tejkalonte për arsye objektive (procedura kushtetuese e hyrjes së një ligji në fuqi), atë afat.

Gjithashtu, me kthimin e ligjit për rishqyrtim, Presidenti duket të ketë ushtruar edhe kompetenca legislative duke hyrë në afate materiale të projektligjit, gjë që, tradicionalisht, nuk është detyrë e tij. Diskrecioni i Presidentit për datën e zgjedhjeve është tepër i kufizuar, pasi ligji zgjedhor përcakton vetëm dy data për mbajtjen e zgjedhjeve brenda periudhës zgjedhore, dhe për zgjedhjet e radhës janë vetëm datat 21 dhe 28 Qershor 2009.

Megjithatë, të ndodhur para faktit që ligji është kthyer për rishqyrtim, pasojave që ky kthim shkakton në lidhje me zbatimin e piramidës së afateve për përgatitjen e zgjedhjeve, si dhe nisur nga interpretimi juridik që Presidenti i ka bërë afatit për nxjerrjen e dekretit, dhe njëkohësisht nevojës që ai ndjen për një afat të përcaktuar ligjor, si zgjidhje më e udhës do të ishte përfshirja në Kod e një dispozite tranzitore që adreson më së miri nevojën ligjore të Presidentit për dekretimin e zgjedhjeve të radhës.

Në lidhje me pikën tjetër të detyrës për disa amendamente të paraqitura nga LSI dhe PDK, bazuar në Vendimin Nr.226, datë 15.12.2008 të Kuvendit, i cili ka përcaktuar se “Komisioni ka për detyrë shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës, nr. 5960,

datë 02.12.2008 “Për kthimin e ligjit nr.10019, datë 18.11.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, mund të konkludojmë që ato dalin jashtë objektit të punës dhe kompetencës së këtij komisioni.

#### IV. Konkluzione

Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Komisioni i Reformës Zgjedhore arrin në përfundimet e mëposhtme:

1. Amendamenti i propozuar plotëson kërkesën e parashtruar nga Presidenti i Republikës me dekretin e tij. Ai bën të mundur që Presidenti i Republikës të nxjerrë dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve pas hyrjes në fuqi të Kodit Zgjedhor.
2. Me këtë amendament përjashtohet çdo mundësi për keqkuptim apo keqinterpretim lidhur me datën e zgjedhjeve. Presidenti i Republikës është i detyruar që, në konsultë me partitë politike parlamentare, të dekretojë si datë të zgjedhjeve të ardhshme parlamentare një nga dy datat ligjërish të mundshme, 21 Qershor ose 28 Qershor 2009.
3. Amendamentet e paraqitura, përkatësisht nga LSI-ja dhe nga PDK-ja, meqënëse nuk janë brenda objektit dhe kompetencës së Komisionit, nuk u morën në shqyrtim prej tij.
4. Komisioni i propozon Kuvendit miratimin e dispozitës kalimtare dhe përfshirjen e saj në tekstin e konsoliduar të Kodit Zgjedhor.

**Bashkëkryetar**

**Ilir RUSMALI**

**Bashkëkryetar**